

VENDIM
Nr. 13, datë 6.4.2022

**PËR PEZULLIM LICENCE PËR 3 MUAJ PËR USHTRIM VEPRIMTARIE DHE
DETYRIMIN PËR MOSNDRYSHIMIN E GJENDJES SË PRODUKTEVE TË NAFTËS DHE
TË GAZIT, SUBJEKTIT “BREGU OIL” SHPK**

Bordi i Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit, në mbështetje të pikës 2, të nenit 21/8, të aktit normativ nr. 8, datë 25.3.2022, “Për disa shtesa në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, ‘Për përpunimin, transportin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre,’” të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Dhënien e masën administrative ndaj subjektit “Bregu Oil” sh.p.k., me NIPT: L42823001F, “Pezullim licence për 3 muaj për ushtrim veprimtarie dhe detyrimin për mosndryshimin e gjendjes së produkteve të naftës dhe gazit”.

2. Ky vendim është i detyrueshëm për subjektin “Bregu Oil” sh.p.k. me NIPT: L42823001F, me adresë: Cukalat–Donofrosë–Berat.

3. Strukturat përgjegjëse për ekzekutimin e këtij vendimi, përkatësisht, inspektorati shtetëror përgjegjës pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe Njësia Administrative Cukalat – Berat, ekzekutojnë aktin me botimin në Fletoren Zyrtare.

4. Ky vendim të publikohet në Fletoren Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet.

Kryetare: Delina Ibrahimaj,

Anëtarë: Belinda Balluku, Ceno Klosi, Genti Gazheli, Niko Lera, Ilia Gjermani, Enea Karakaçi, Sezar Beqaj, Artur Llogoni, Gerian Kuqi, Agron Bulku, Saimir Krasniqi